



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

**THIRRJE PËR MODERATOR
PËR FORUMIN E BIZNESIT SHQIPËRI – EGJIPT
14 DHJETOR 2025**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) shpall thirrjen për moderator për Forumin e Biznesit Shqipëri – Egjipt, që do të zhvillohet me 14 dhjetor 2025. Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin një aplikim që konsiston në moderimin e aktiviteteve nga ana e tij.

Përshkrim i eventit dhe i asaj që pritet nga moderatori

Forumit e Biznesit Shqipëri – Egjipt do të zhvillohet me 14 dhjetor 2025, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë dhe do ketë pjesëmarrës të rëndësishëm nga bota e biznesit, ndaj për moderimin e tij nevojitet një profil moderator me njohuri nga biznesi dhe folës i shkëlqyer i gjuhës angleze. Moderatorit duhet të moderojë eventin dhe nga ana e tij kërkohet një angazhim prej 5 orësh.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptarë;
- të kenë mbi 5 vite eksperiencë pune në fushën e moderimit;
- të kenë fituar një profil të rëndësishëm kombëtar në fushën e kërkuar;
- të jetë njohës dhe folës i shkëlqyer i gjuhës angleze;

Dosja e aplikimi duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:

- Kërkesë/Letër interesi
- Jetëshkrimi/Curriculum Vitae;
- Dokumentacioni që vërteton eksperiencën të mëparshme në punë të ngjashme, si kontrata, etj;
- Fotokopje ID/Pasaportë;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Buxhet i detajuar për shërbimin.

Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 10.12.2025, ora 16:30.

Procedura e Përzgjedhjes

Projekt-propozimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë. Fituesi do të shpallet brenda datës 15.12.2025.

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:

- karriera e moderatorit;
- aftësia e tij për të moderuar dhe realizuar programacionin në event;
- realizueshmëria financiare në kontekstin e burimeve në dispozicion.

Aplikimi dhe dorëzimi i dosjes së aplikimit me të gjitha dokumentat e cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.